



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data 07.04.2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mallra ushqimore për kopshtin me drekë”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Mish viçi dhe produkte nga mishi i viçit:15131600-1, Fruta, perime dhe produkteve të përfaqëruara:15300000-1, Produkte të qumështit:15500000-3, Produkte ushqimore të ndryshme;Produkte ushqimore të ndryshme:15800000-6,**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1 416 650 (një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh,**

**Argumentimi i fondit limit:**Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer nëpërmjet tre ofertave. Nga ofertat e marra nga subjektet që operojnë në aktivitete të gjashme me objektin e këtij prokurimi, komisioni ka vendosur çmimet në baz të mesatares së ofertave ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.Dokumentuar me relacionin e KLLFLST nr.2014/2prot,datë 18.03.2026 .

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar në sektorin klasik, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar “nenin 49 ;në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”nenin11, pika 1, gërma b) dhe neni 55,74,77 i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, kreu II pika 2/b .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

*b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST-së.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 82 si dhe nëVKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*a. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8 dhe 9.*

- Objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik sipas ekstraktit të QKB-së duhet i ngjashëm me objektin e kesaj procedure prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 39, pika 6/b, dhe neni 88, Pika

4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

*Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik për të përbushur me sukses kontratën.*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

### **2.2.1**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës e përkatësisht: 560 000 lekë pa tvsh.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**2.2.2 Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar,.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

**2.2.3** Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: "**Mallra ushqimore për kopshtin me drekë**", pika 3 e nenit 77 të LPP i ndryshuar, dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit neni 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të

Ministrinë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

**2.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2025 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 280 000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe në nenin 55, pika 4/ b e VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, i ndryshuar parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së i ndryshuar, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjet transporti ATV frigoriferik për furnizimin e kopshtit sipas grafikut të levrimit të mallrave, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës dhe Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATV frigoriferik, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik
- taksat vjetore të mjetit.

Përveç dokumentave të sipërpërmendura, në rastin *qeras:të paraqitet kontrata e marrjes me qeratë mjetit* shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira

2.3.3.Operatori ekonomik pjesmarres duhet të disponojë Certifikate ISO 9001:2015 ose ekuivalente me të, të vlefshme.

Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.

**Argumentim:** në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të vkm nr. 285, datë 19.05.2021, “për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Arsyeja përse është kërkuar automjeti atv është bërë duke marrë parasysh kushtet në të cilat duhet të kryhet transporti i i produkteve ushqimore sidomos kur transportohen nga një distancë e largët nga objekti i kontratës, si dhe duke iu referuar ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “për ushqimin”, i ndryshuar, për transportin e disa produkteve ushqimore kërkohen kushte frigoriferike, për rrjedhojë, automjetet kërkohet të jenë frigoriferikë, d.m.th atv.

**2.3.3.Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje Certificate ISO 9001:2015 ose ekuivalente me të, të vlefshme.**

**Ne rastin e BOE certifikatat duhet te paraqiten nga secili prej anëtareve të BOE.**

**Argumentimi:** Kërkesa e cilësisë të përcaktuara sipas pikës **2.3.3** gërma “a” është vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë të mallve me çmime të ulta.

*Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.,*

**2.3.4 Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje Certificate ISO 22000:2018 ose ekuivalente me të, të vlefshme.**

**Ne rastin e BOE certifikatat duhet te paraqiten nga secili prej anëtareve të BOE.**

**Argumentimi:** Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallrave të kopshtit sipas specifikimeve teknike dhe sipas grafikut të levrimit të mallrave bashkëngjitur preventivit, shtojca 6 & 7 e DST-së.

**Argumentimi:** Me anë të kësaj deklarate synohet OE do të jete i gatshëm të kryejë dorëzimin e mallit sipas specifikimeve teknike dhe sipas grafikut të levrimit në kohë dhe pa problematika, gjatë zbatimit të kontratës

**2.3.6-** Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar ” si dhe përcaktimet e pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, **nr.36, datë.27.03.2026**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Mallra ushqimore për kopshtin me drek”, me fond limit prej: 1 416 650 (një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, lloji i procedurës: E hapur e thjeshtuar**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP, I ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

\*\*\*

**SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:***Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes, bashkengjitur DST ne SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specififikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specififikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Anëtarët pranuan specififikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm :**KLLFLST( Komisioni i Ilogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.2014prot,datë 12.03.2026,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat që do të blejë. Për sa I përket specifikimeve teknike komisioni për hartimin tyre dhe të preventivit me cmime, referencat i ka marë nga **Duke iu referuar Standardeve Shtetërore, Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.**

**:Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes konkretishtë nga KLLFLST ,dorëzuar dokumentacioni teknik si specififikimet teknike te mallrave dhe preventivi me procesverbalin e komisionit nr.2014/1prot,datë 18.03.2026dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave.**

**Preventivi I hartuara nga KLLFLST si mëposhtë për objektin: “Mallra ushqimore për kopshtin me drek ”.**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Bukë Thekre Integrale	Kg	1400
2	Qumesht i Fresket Lope	Lt	1600
3	Kos	Lt	1300
4	Mish Vici	Kg	200
5	Mish Pule	Kg	130
6	Gjize Lope pa kripe	Kg	160

7	Veze	Kokerr	5800
8	Recel Kumbulle	Kg	42
9	Miell Gruri/Niseshte	Kg	100
10	Tershere	Kg	130
11	Trahana	Kg	40
12	Thjerza	Kg	90
13	Fasule	Kg	105
14	Sheqer	Kg	75
15	Miell Misri	Kg	50
16	Oriz	Kg	115
17	Makarona	Kg	90
18	Vaj Ulliri	Lt	200
19	Djath	Kg	35
20	Patate	Kg	320
21	Qepe e thate	Kg	75
22	Karrota	Kg	200
23	Domate	Kg	200
24	Kastravec	Kg	90
25	Bizele	Kg	105
26	Banane	Kg	253
27	Fruta Te Stines(Molle,Portokalle,Qersh,Kajsi)	Kg	1300
28	Zarzavate(Kungull,Laker,Spinaq)	Kg	300
29	Kripe	Kg	35
30	Limon	Kg	25
31	Rigon	Kg	3
32	Fryres Keku	Kg	4
33	Majdanos	Tufe	300
34	Kartopoceta	Pako	900
	<b>TOTALI PA TVSH</b>		
	<b>TVSH 20%</b>		

	<b>TOTALI ME TVSH</b>		
--	-----------------------	--	--

**Afatet e lëvrimt:**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi I mallit</b>	<b>Grafiku I levrimit te ushqimeve</b>
1	Buke thekre intergrale	5/ne jave
2	Qumesht i fresket lope	5/ne jave
3	Kos	5/ne jave
4	Mish vici	2/jave
5	Mish pule	1/jave
6	Gjize lope pa kripe	3/ne jave
7	Veze	3/ne jave
8	Recel kumbulle	1/jave
9	Miell gruri /niseshte	1/jave
10	Tershere	1/jave
11	Trahana	1/jave
12	Thjerreza	1/jave
13	Fasule	1/jave
14	Sheqer	1/jave
15	Miell misri	1/jave
16	Oriz	1/jave
17	Makarona	1/jave
18	Vaj ulliri	1/jave
19	Djath	1/jave
20	Patate	1/jave
21	Qepe e thate	1/jave
22	Karrota	3/jave
23	Domate	2/jave
24	Kastravec	2/jave
25	Bizele	1/jave
26	Banane	1/jave
27	Porttokalle	2/jave
28	Molle	2/jave
29	Zarzavate (kungull laker spinaq etj)	4/jave
30	Kripe	1/jave
31	Limon	1/jave
32	Rigon	1/jave

33	Fryres keku	1/jave
34	Majdanos	1/jave
35	Kartopeceta	1/jave

**Afatet e levrimit:** Fillon nga data e lidhjes së kontratës dhe mbaron deri më **12( dymbëdhjet) muaj**, levrimi mallit do te kryhet sipas grafikut te levrimit te percaktuar bashklidhur preventivit më sipër.

Sqarim: Te grafiku citimi 5/ne jave, 4/ne jave, 3/ne jave, 2/ne jave, 1/ne jave, nënkupton se sa here në javë kontraktori ka detyrimin të furnizoj cerdhen me secilin produkt ushqimor.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t'u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

### **NJËSIA E PROKURIMIT:**